

AKT-THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“H.V.E 23” SHPK.

Në bazë të nenit 230/2 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Asambleja e Përgjithshme (Ortaket), sot në datën 30.01.2023 perpilon kete Akt Themelimi per themelimin e shoqërise “H.V.E 23” SHPK, me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Pjesa e përgjithshme*

Akti i themelimit, statuti, dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “H.V.E 23” SHPK.

KREUI

*Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakeve*

NENI 1

*Emri*

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “H.V.E 23” SHPK

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

NENI 2

*Forma*

2.1 Shoqëria tregtare “H.V.E 23” SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

*Zyra Qendrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “H.V.E 23” SHPK do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Rr.e Vilave Kompleksi Sunrise residence Zona 5 Njësia 1.

NENI 4

*Objekti i Veprimtarisë*

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në:

Ne **fushën e ndertimit, transportit, import-export** brenda dhe jashtë territorit të vëndit. mport-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjithë materialeve dhe pajisjeve elektrike, produkteve ushqimore e industriale, të prodhimeve bujqësore. Shitje mallra të ndryshme me shumicë dhe pakicë, eksport. import, shërbime të ndryshme. Ndërtim, projektim supevizion zbatim, punime dheu, sistemime. tarracime terrenesh, ndërtime civile.Ndërtime vepra arti të vogla, dhe te medha. Në fushën e shërbimit të transporteve (tokësor, hekurudhor, ajror, telekomunikacioni) transferta financiare,

sigurim e shërbime të tjera, punime elektrike. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë.

**NENI 5**  
***Kohëzgjatja***

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “H.V.E 23” SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

**NENI 6**  
***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

6.1 Shoqëria tregtare “H.V.E 23” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
***Përgjegjësia e Ortakut***

7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “H.V.E 23” SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

**KREU II**  
***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit***

**NENI 8**  
***Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “H.V.E 23” SHPK është 10.000 (dhjetëmije) lekë .

8.2 Ortakët e shoqërisë janë zotërues të kuotave me vlerë 10.000 (dhjetëmije) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë. Halit Valteri 35% Vebina Resuli 33% Ernest Qordja 32%.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortakët e shoqërisë.

**KREU III**  
***Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë***

**NENI 9**  
***Riorganizimi i Shoqërisë***

9.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

9.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (të Ortakëve).

**NENI 10**  
***Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë***

10.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Të Ortakëve).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

10.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 11**

11.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt Themelimi do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

*Ky Akt Themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

**ORTAKËT THEMELUES**

**Vebina Resuli**

*Vebina Resuli*



**Ernest Qordja**

*Ernest Qordja*



**Halit Valteri**

*Halit Valteri*

